



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,**  
**trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**

**Prot.**

**Tiranë / /2022**

**Nr. Dok.202200756/2**

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të paraburgosurve në IEVP Tropojë.*

**Drejtuar:** **Z. Admir ABRIFA**  
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

**TIRANË**

**Z. Besart HAXHIAJ**  
Drejtor i Komanduar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale

**TROPOJË**

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tropojë.

Inspektimi u krye më datë 19.05.2022, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve në IEVP Tropojë për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave të paraburgosur; trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të paraburgosurve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim; si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e zhvilluar më parë në datë 17.04.2020<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Shkresë nr. K4/172-2 prot, datë 17.04.2020 “Rekomandime për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të paraburgosurve në IEVP Tropojë”.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet e sistemit penitenciar, grupi i inspektimit u takua me Drejtorin e komanduar të IEVP Tropojë z. Besart Haxhiaj, i cili pas prezantimit u informua në lidhje me qëllimin e inspektimit, ambientet që do të inspektohen, intervistat që do të zhvilloheshin me të paraburgosurit, si dhe dokumentacionin që do të verifikoheshin, një kopje e të cilit do të vihej në dispozicion edhe të grupit të inspektimit.

Grupi i inspektimit kërkoi fillimisht nga Drejtori i IEVP-së një informacion të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të burgosurve në këtë IEVP, kushtet në të cilat ndodhen ambientet në regjimin e brendshëm, mënyrën e zgjidhjes nga ana e institucionit të kërkesë/ankesave të të paraburgosurve, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit pas inspektimit të mëparshëm.

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tropojë për vitin 2022.

Nga informacioni rezultoi se, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr.8927/1, datë 27.09.2018 “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tropojë, është klasifikuar burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion siguri të zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Organika e institucionit përbëhej nga 41 punonjës, prej të cilëve 9 punonjës ishin staf civil dhe 32 ishin punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë së institucionit. Aktualisht organika e IEVP Tropojë, përbëhej nga sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektori ligjor, sektori financiar, sektori i logjistikës, sektori shëndetësor dhe sektori i policisë. Ky sektor, përbëhej nga 1 (një) mjek i përgjithshëm part-time, 3 (tre) ndihmës mjekë dhe 1 (një) farmacist. Në tërësi organika ishte e plotësuar, por kishte mungesa në pozicionin e shefit të policisë dhe në sektorin shëndetësor, në organikë nuk kishte stomatolog, në raste urgjence të burgosurit në shoqërimin e stafit policor dërgoheshin në klinikat private.

Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Tropojë kishte një kapacitet maksimal prej 26 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 20 persona, nga të cilët 9 persona të dënuar dhe 11 të paraburgosur, duke patur një numër brenda kapacitetit zyrtar të këtij institucioni. Ndarja midis dy sektorëve që ndodhen në të njëjtin korridor, kryhej me anë të një skare.

Gjithashtu, grupi i inspektimit i kërkoi informacion Drejtorit të institucionit në lidhje me dokumentacionin ligjor që përcakton kapacitetin e IEVP-së. Drejtori i institucionit na informoi se nuk ka urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me kapacitetin zyrtar të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, por i referohen planit të ndërtimit të institucionit i cili është planifikuar me këtë kapacitet.

Në zbatim të nenit 33, pika 4 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, thuhet se në vendosjen e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, si dhe kushtet e

mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke u siguruar kubatura jo më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m<sup>2</sup> për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se kapacitetet duhen të përcaktohen me urdhër nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për kapacitetin zyrtar të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, sipas pikës 4 të këtij neni, në lidhje me mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes, në mënyrë që të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe të plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit.

Grupi i inspektimit, në vijim mori informacion për dinamikën e popullimit edhe për 6 mujorin e fundit, nga ku rezultoi se fenomeni i mbipopullimit ka qenë karakteristikë në IEVP Tropojë për këtë periudhë. Më konkretisht:

- Janar 16 persona
- Shkurt 23 persona
- Mars 19 persona
- Prill 20 persona

Gjatë inspektimit, asnjë person i dënuar apo i paraburgosur nuk flinte në dysheme, por të gjithë ishin të pajisur me shtretër, materiale për fjetje, si dhe dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale, ushqimeve etj.

Nga ana e drejtuesit dhe stafit të institucionit, grupit të inspektimit ju ofrua akses i plotë sipas parashikimeve të Rregullores së Brendshme, për kryerjen e inspektimit në të gjitha ambientet e institucionit, si dhe për zhvillimin e intervistave me personat e paraburgosur që vuanin dënimin në këtë institucion.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga rekomandimi i datës 17.04.2020, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, si dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi:

- **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për mundësinë brenda skemës së sigurisë të hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen në ambientet e brendshme gjatë stinës së dimrit.
- **Ishte zbatuar rekomandimi**, për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe të rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tropojë, sipas kontratës tre palëshe IEVP Tropojë, ISKSH, depo farmaceutike.

Ndërkohë që, një pjesë e rekomandimeve të mëparëshme të paraqitura nga Avokati i Popullit, nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar.

Më konkretisht:

- **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për mbajtjen e arkës në institucion për të mundësuar blerjet nga ana e të paraburgosurve dhe të dënuarve ose pajisjen e tyre me karta bankare.

- **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për miratimin dhe materializimin e planit për zgjerimin e ambienteve të ajrimit për të dënuarit /paraburgosurit në IEVP Tropojë.
- **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e ambienteve të përshtatshme për ofrimin e kurseve arsimore dhe atyre të formimit profesional.

Grupi i inspektimit në vijim të punës, vizitoi mjediset në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tropojë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin e disa praktikave që kanë të bëjnë me të drejtat e të burgosurve, si dhe zhvilloi intervista në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit në dhomat e tyre.

Në përfundim, grupi i inspektimit administroi gjithashtu kopje të dokumentacionit të disa praktikave sipas sektorëve, konkretisht:

- Organikën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tropojë.
- Urdhërin për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.
- Praktikën e masave disiplinore.
- Fotokopjen te kontratës individuale të punës.
- Praktikën e punës të Komisionit të Pritjes.
- Planin e aktiviteteve të Sektorit të Kujdesit Social.
- Disa dosje në lidhje me çështjet psiko-sociale.

## 1. Trajtimi

Gjatë vizitës monitoruese grupi i ekspertëve vizitoi të gjitha ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tropojë dhe kontaktoi me të dënuarit/ paraburgosurit, duke patur në vëmendje mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve dhe të dënuarve në IEVP, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të dhunës fizike, apo të ushtrimit të forcës tej kufijve të parashikuar nga aktet normative<sup>2</sup>, në fuqi.

Nga bisedat e realizuara me të paraburgosurit dhe të dënuarit, në dhoma më vete, pa praninë e punonjësve të institucionit, nuk rezultoi të kishte ankesa apo pretendime për ushtrim dhune fizike apo psikologjike. Po ashtu, nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se prej një periudhe të gjatë nuk kishte situata të përdorimit të masave disiplinore ndaj të paraburgosurve, falë marrëdhënieve pozitive të ndërtaura ndërmjet të paraburgosurve, si edhe midis tyre e stafit të institucionit, por edhe numeri relativisht të vogël të të dënuarve apo të paraburgosurit.

Personat e moshës 18-21 vjeç **nuk** ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të burgosurit e tjerë. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të burgosurit e tjerë. Për gjatë inspektimit u morë kontakt me këta persona të cilët nuk shprehen ndonjë ankesë në lidhje me këtë gjë. Ajrimi dhe veprimtaritë me karakter sportiv dhe edukativ, për shkak të situatës së pandemisë, vijonin të zhvilloheshin me grupe të vogla dhe të ndara sipas grup moshave dhe interesave të të burgosurve.

Të burgosurit u shprehën të kënaqur me shërbimin shëndetësor, si dhe me mënyrën me të cilën trajtoheshin kërkesat dhe ankesat e tyre nga stafi. Të paraburgosurit dhe të dënuarit, u shprehën të

<sup>2</sup> Neni 2 "Parimet e përgjithshme", Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.

kënaqur me shërbimin shëndetësor dhe gatishmërinë e stafit mjekësor, në përgjigje të kërkesave për ndihmë mjekësore, si në rastet e urgjencës, ashtu dhe në përmbushjen e kërkesave për konsulta të specializuara.

Po ashtu, thuajse të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit u shprehen të kënaqur në lidhje me ushqimin e servirur në institucion.

Takimet, telefonatat dhe shërbimet e tjera ofroheshin në mënyrë të drejtë për të gjithë. Kur prej të burgosurit kërkoheshin takime shtesë me familjarët, ato rezultojnë të mundësuar në çdo rast. Takimet zhvilloheshin në rregull sipas planifikimeve, në një ambient me dy poste, pa kufizime, të pajisur me një tavolinë dhe disa karrige në kushte të mira.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Një kërkesë e vazhdueshme e të burgosurve e evidentuar edhe nga vitet e kaluara, kishte të bënte me hapjen e një njësie tregtare brenda ambienteve të këtij institucioni, për blerjen e produkteve ushqimore apo produkteve të tjera të nevojshme.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit e kishin të vështirë të mbulonin nevojat e tyre për blerje, nëse nuk kishin mbështetjen familjare apo të bashkëvuajtësve të tjerë. Veçanërisht pamundësia e blerjeve ndikonte tek shtetasit e huaj dhe tek ata të braktisur nga familja. Nga intervista me të dënuarit konstatoam se 4 prej tyre për shkak të largësisë nga vendbanimi i tyre e kishin të pamundur ndihmesën nga familjarët e tyre.

Të burgosurit, ngritën ankesa për nivelin e lagështirës, si dhe për mungesën e ajrimit dhe dritës natyrale. Pavarësisht investimit të kryer me fondet modeste të institucionit, lagështia ishte prezente në disa dhoma banimi, si dhe në ambientin e tualetit dhe të dusheve të përbashkëta për larjen e trupit.

Nga informacioni dhe intervistat me të burgosurit, u evidentua gjithashtu edhe problemi i ngrohje/ftohjes në dhoma dhe mungesa e një sistemi qendror, që do të realizonte këtë gjë. Në mungesë të këtij sistemi, drejtuesit e institucionit për periudhën e dimrit kishin lejuar mbajtjen e pajisjeve elektrike të siguruara nga familjarët e të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Po ashtu, kishte ankesa dhe pretendime lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore. Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e MKPT-së. Institucionit të Avokatit të Popullit, ato do t'ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe organeve të larta të drejtësisë.

## **2. Masat mbrojtëse**

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Të paraburgosurit/dënuarit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese, në mungesë të kutisë i dorëzoheshin punonjësit të sektorit psiko-social, të hapura dhe më pas seleksionoheshin për të përcaktuar destinacionin e tyre. Më tej, punonjësi i edukimit,

kërkesë/ankesat e të burgosurve, brenda ditës i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili nëpërmjet sektorëve përgjegjës, kthente përgjigje në kohë sa më të shpejt. Në regjistrin përkatës u konstatua se kishte vetëm kërkesa, nuk pati ankesa për mosveprim në lidhje me marrjen dhe adresimin e ankesave.

Nga verifikimi i regjistrin, objekti i kërkesave të të burgosurve kishte të bënte me kërkesa për blerje TV, biseda në SKYPE me familjen, aplikim për hapje llogarie në bankë, mungesa të medikamenteve mjekësore, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike etj.

Komunikimet me telefon me familjet e tyre, të burgosurit i zhvillonin normalisht në telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe të burgosurit kryenin 8 telefonata në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre. Nga kontakti me të burgosurit konstatuam se ata mund të komunikoni lirisht me institucionin e Avokatit të Popullit.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në I EVP Tropojë, kishte 1 post për takime online, 1 post për takime fizike me familjarët e të dënuarve, dhe 1 post për takime për të paraburgosurit. Ndërsa dhoma prindërimi në distancë dhe dhoma për takime speciale me familjarët nuk kishte. Nga intervistat, rezultoi se të burgosurit zhvillonin 4 takime fizike, ku një nga këto takime me kërkesë të burgosurit bëhet online, për të cilat nuk kishin ankesa në lidhje me planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve.

Në I EVP Tropojë ishin të punësuar 4 të dënuar/paraburgosur, siç ishte përcaktuar sipas strukturës organike, në pozicione pune si sanitarë, ndihmës kuzhiner, shpërndarës ushqimi etj. Sipas intervistave me të burgosurit, punësimi paraqet interes për sa kohë që kushtet e punësimit dhe shpërblimi janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 209 datë 06.04.2022, si dhe VKM nr.602 datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”; të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 169, datë 16.05.2022 “Për lidhjen e kontratës së punës me të burgosurit e punësuar për nevoja shërbimi në I EVP dhe pagesat e tyre”.

### **3. Kushtet materiale**

Grupi i monitorimit, inspektoi plotësimin e kushteve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, sipas kërkesave ligjore dhe në respektim të standardeve më të mira për jetesë dhe aktivitetet e të paraburgosurve.

Ndërtesa e këtij institucioni përbëhej nga dy kate dhe një kat pjesërisht nëntokë, vetëm nga njëra anë. Ky i fundit ka dalje të drejtpërdrejtë mbi tokë (nga ana tjetër), jashtë godinës, pasi vetë ndërtesa është e pozicionuar mbi një pjesë kodrinore. Në këtë kat, pjesërisht nëntokë ndodhej kuzhina e institucionit.

Në katin e parë të ndërtesës gjendej dhoma e takimit me familjarët dhe avokatin, vendqëndrimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë, një ambient për magazinë dhe regjimi i brendshëm.

Në hyrje të regjimit të brendshëm ndodhej infermiera. Në korridor ishte vendosur kabina e telefonit. Të drejtat dhe detyrat e të dënuarve dhe të paraburgosurve ishin të afishuara po aty.

Në regjimin e brendshëm, gjendeshin 6 dhoma për 3 persona dhe 2 dhoma secila për 1 person. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina, stola dhe rafte për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të paraburgosurve. Materialet për fjetje si dyshekët, batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura. Kubatura e dhomave ishte më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit ishte më pak se 4 m<sup>2</sup>, për çdo të burgosur. Në lidhje me kushtet fizike të dhomave, u konstatua se dritaret e dhomave të regjimit të brendshëm, ishin dritare të vogla e të pamjaftueshme për ajrosje dhe ndriçim natyral. Nga vizita në dhoma u vu re se ato ishin kryesisht të pastra dhe të lyera, por nuk e respektonin hapësirën jetike, gjë e cila krijonte problem për ajrosjen.

Në këto kushte, duke vlerësuar kushtet e klimës së zonës, hapësirës së nevojshme për jetesë për person, mungesës së ajrimit, ndriçimit, mjediseve të pamjaftueshme në regjimin e brendshëm në këtë institucion, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se ambientet përgjithësisht nuk garantojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe nuk plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike sipas standardeve të të paraburgosurve dhe të dënuareve.

IEVP Tropojë kishte vetëm një dhomë veçimi, e cila ishte e kompletuar me një krevat dhe materiale për fjetje, në të njëjtat kushte me dhomat e tjera. Në momentin e inspektimit në dhomën e veçimit nuk kishte asnjë të paraburgosur me masë disiplinore.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte 24 orë, të burgosurit nuk ngritën shqetësim në këtë drejtim.

Mjedisi i ajrimit kishte dy ndarje ajrimi, ku njëra shërbente për të paraburgosurit, ku ishin vendosur 6 stola për uljen e të paraburgosurve gjatë ajrimit dhe tjetra për të dënuarit ku mund të qëndronin 5 deri 8 persona. Kërkesat e të burgosurve për zhvillimin e aktiviteteve sportive nuk plotësoheshin, pasi mungonin mjediset dhe infrastruktura për zhvillimin e tyre.

Hapësira e ajrimit ishte e vogël për organizimin e lojërave përtej atyre të tavolinës, pasi edhe kjo hapësirë ishte e ndarë në dy poste të veçuara për të paraburgosurit dhe të dënuarit. U konstatua që kishte një plan afatshkurtër për zgjerimin e ambienteve të ajrimit duke lidhur këto ambiente me fushën e kalçetos dhe krijimin e hapësirave të reja të përshtatura për zgjerimin e ambienteve të ajrimit për të dënuarit/paraburgosurit.

Për larjen e rrobave të të burgosurve, mungonte lavanderia, por si e tillë shërbente një lavatriçe e cila funksiononte dhe ishte e vendosur në një ambient, i cili shërbente dhe si palestër dhe për larje rrobash në regjimin e brendshëm. Ajo përdorej vetëm për larjen e rrobave apo të çarçafëve, por sipas pretendimit të burgosurve ky proces vonohej shumë, ndaj ata preferonin që këtë shërbim ta merrnin nga familjet e tyre. Gjithashtu në këtë ambient kishte dhe vegla, si shtanga, gira etj., me të cilat të burgosurit bënin stervitje.

Nga inspektimi rezultoi se ambienti i tualetit/dusheve ishte funksional dhe i pajisur me nyje të reja hidrosanitare. Kalendari i dusheve ndodhej i afishuar, gjithsesi nga pohimet e të paraburgosurve/dënuarve u konstatua se nuk kishte pengesa dhe kufizime në bërjen e dusheve dhe përtej parashikimeve të planifikuara.

Ambientet e institucionit furnizoheshin me energji elektrike nga rrjeti elektrik i zonës. Gjithashtu, kishte dhe burim rezervë për furnizimin me energji elektrike me gjeneratorë.

Gjatë vizitës në kuzhinën e IEVP-së, u konstatuan kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe ambientet ishin të pajisura me mjete të reja dhe të përshtatshme gatimi. Në të punonin dy kuzhinierë. Menuja ditore gjendej e afishuar dhe gramaturat ishin brenda standardeve. Librezat shëndetësore gjendeshin po aty. Kampionet e ushqimeve të gatuar një ditë më parë ruheshin në kushte frigoriferike. Gjithësesi ka nevojë për përmirësime të ndjetës ushqimore, shqetësim i vazhdueshëm i Avokatit të Popullit.

Sa i përket çështjes së sigurisë, sistemi i monitorimit me kamera në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm ekzistonte dhe ishte funksional. Ato mbanin në vëzhgim mjediset e këtij institucioni për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore.

#### **4. Regjimi dhe aktivitetet**

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale ishte i afishuar. Në ambientet e IEVP-së ishin të afishuara posterat e Avokatit të Popullit, ku specifikoheshin të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve, gjithashtu edhe numrat e kontaktit. Nga bisedat me të paraburgosurit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet që kryhej sipas parashikimeve ligjore.

Orari i veprimeve ishte i afishuar. Në lidhje me ajrimin, rezultoi se të paraburgosurit/dënuarit qëndronin më vete 4-5 orë në ajrim, 2-3 orë paradite dhe 2 orë pasdite. Në ambientet e ajrimit zhvilloheshin lojëra si shah, domino, letra etj., ndërsa hapësira për ecje ishte mjaft e kufizuar.

Për shkak të mungesës së dhomës së aktiviteteve, nuk ofroheshin mjaftueshëm kurse arsimore dhe kurse të formimit profesional, por sipas rastit në korridor ose në ambientet e ajrimit mundësohej trajtimi i temave të ndryshme dhe recensionet e librave. Megjithatë kufizimet infrastrukturore, specialisti i sektorit psiko-social, punonte në mënyrë aktive që të mundësonte aktivitetet e ndryshme social- kulturore.

Në këtë Institucion, ndodhej edhe një ambient që shërbente si bibliotekë, që kishte një numër të reduktuar me tituj librash, të cilët ishin dhuruar nga organizata jofitimprurëse, por nuk kishte ambiente për kryerjen e riteve fetare për të burgosurit e fesë myslimane dhe asaj të krishterë.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit duhet të jetë proaktiv për të krijuar sa më shumë aktivitet, pasi ka një rëndësi të veçantë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare. Ky proces duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe të të paraburgosurve dhe të dënuarve, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri dhe i dënuari, veprën penale, si dhe faktorët e riskut.

Avokati i Popullit vlerëson se ky institucion nuk i ka kushtet infrastrukturore për të realizuar procesin rehabilitimit dhe realizimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve siç parashikohet nga ligji nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Në institucion nuk kishte persona të kategorizuar me probleme të shëndetit mendor, e megjithatë specialisti i kujdesit social i kontaktonte dhe punonte çdo ditë me të paraburgosurit dhe të dënuarit.



Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale rezultoi se ato ishin të plotësuar mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të paraburgosurit, vlerësimet e sjelljes dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Në këto kushte, në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale në Tropojë, janë të domosdoshme organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore, çlodhëse e sportive me të paraburgosurit. Këto aktivitete, duhet të shërbejnë për motivimin dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë, rritjen e vetëbesimit, si dhe nxitjen e interesit për arsimimin dhe formimin profesional të të paraburgosurve.

Nga intervistat me të paraburgosurit ata ngritën si shqetësim ndërtimin e një fushe futboli, pavarësisht se ata kanë improvizuar një fushë nga ana e tyre. Ata u shprehën se do të ishte mirë krijimi i një fushe sporti, e cila do të ndikonte shumë në gjendjen e tyre shpirtërore dhe fizike.

Në këtë kuadër, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*<sup>3</sup>.

## **5. Shërbimet shëndetësore**

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhet nga 1 mjek me kohë të pjesshme që ofron 90 orë shërbime në muaj dhe 3 ndihmës mjekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se të gjithë librat/regjistrat ishin të plotësuar në mënyrë të rregullt dhe kartelat mjekësore mbaheshin në dollap të kyçura.

Dhoma e mjekut, infermierisë dhe farmacia ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura. Infermiera gjendej brenda në regjim dhe ishte e rregullt, e pajisur me krevat vizitash, aparat tensioni, mjekime të urgjencës dhe terapinë ditore.

Në Organikën e IEVP Tropojë nuk kishte stomatolog dhe në kushte të tilla, shërbimi stomatologjik mundësohej jashtë institucionit nga ofrues privatë, me rekomandimin e mjekut, dhe mbulohej financiarisht nga familjarët e të burgosurve.

Referuar nenit 41 të ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në pikën 3 thuhet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve. Organizimi dhe realizimi i kujdesit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me qendrën spitalore të burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë. Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon shtimin në organikë të pozicionit për stomatolog dhe krijimin e një dhomë të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim në lidhje me ofrimin e shërbimit shëndetësor për të burgosurit.

Lista e të sëmurëve përbëhet nga 7 të sëmurë kronik dhe 1 i sëmurë me diabet, të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjekësore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

---

<sup>3</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve; Pika 25/1 dhe 25/2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tropojë, nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë në një kohë që për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjënës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon në këtë institucion.

Autoambulanca në këtë institucion mungonte prej kohësh, por lëvizjet për në Qendrën Spitalore Universitare (QSUT) Tiranë, mundësoheshin me automjetin e Komisarariatit të Policisë Tropojë.

Grupi i inspektimit, konstatoi se institucioni ishte furnizuar rregullisht me ilaçe, si për rastet urgjente, ashtu edhe për mjekimin e të sëmurëve kronikë. Furnizimi me ilaçe bëhej sipas skemës së rimbursimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe me ilaçe të siguruara nga fondi i veçantë në dispozicion të Institucionit. Nga ana e sektorit shëndetësor trajtoheshin me medikamentin “metadon” disa të sëmurë kronikë.

Nga këqyrja e dokumentacionit, si regjistri për vizitat e kryera nga stafi mjekësor i institucionit ashtu dhe regjistri i të sëmurëve kronikë për konsultat jashtë institucionit ishte i plotësuar në mënyrë korrekte në të gjitha rubrikat. Gjithashtu, në dhomën e mjekut ndodhej edhe “Libri për ekzaminimin e rasteve të keqtrajtimin dhe të dhunës”. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura në rregull.

Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ishin plotësuar sipas rubrikave. Në disa raste, për shkak të dinamikës së transferimeve nga një institucion penitenciar në tjetrin, kishte vonesë në plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me librezë shëndetësore.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ku parashikohet midis të tjerash se: “Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruar”*.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për rikonstruksionin e plotë të godinës së banimit të të paraburgosurve në IEVP Tropojë për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, zgjerimin e dritareve të dhomave për futjen e ajrit dhe dritës natyrale sipas kriterëve teknike të sigurisë.
2. Marrjen e masave për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6 m<sup>2</sup> dhe 4m<sup>2</sup> për person.

3. Marrjen e masave për miratimin dhe materializimin e planit për zgjerimin e ambienteve të ajrimit për të dënuarit /paraburgosurit në IEVP Tropojë.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin sipas strukturës organike të sektorit shëndetësor të institucionit me 1 mjek të përgjithshëm me kohë të plotë dhe shtimin në organikë të një 1 mjeku stomatolog, me kohë të plotë me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit.
5. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këtë kategori.
7. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të përshtatshme për ofrimin e kurseve arsimore dhe kurseve të formimit profesional.
8. Marrjen e masave për instalimin e sistemit qendror për ngrohje/ftohjen e ambienteve të brendshme të institucionit, si dhe garantimin në çdo kohë të furnizimit me ujë të ngrohtë për mbajtjen e higjënës personale të të paraburgosurve dhe të ambienteve të përbashkëta, në përshtatje dhe me kushtet klimaterike të zonës.
9. Marrjen e masave të nevojshme për hapjen e njësisë tregtare për ofrimin e produkteve bazë të domosdoshme për të paraburgosurit në IEVP Tropojë.
10. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një fushe futbolli në ambientet e IEVP Tropojë për vendosjen e një standardi argëtues dhe çlodhës për të paraburgosurit në këtë institucion.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e dhomave të prindërimit dhe pajisjen e tyre me bazë materiale për të mundësuar realizimin e takimeve mes të dënuarve dhe fëmijëve të mitur të tyre në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit **30 ditor** sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**